

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA”
DHE
YMCA MOVEMENT – YMCA LEVZIJE

Sot me datë 06/02/2024 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi, (në vijim referuar si ‘Marrëveshja’) ndërmjet palëve të mëposhtme:

- I. **Universiteti “Haxhi Zeka”** (më tutje: “UHZ”) Rr. “UÇK”-së 30000 Pejë Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Prof. Dr. Armand Krasniqi, Rektor (në tekstin në vijim: “Rektori”) dhe
- II. **Organizata YMCA MOVEMENT – YMCA LEVZIJE** Rr. Ismail Qemali 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Dorina Davies, Drejtor (në tekstin në vijim: “Drejtori”)

Gjithashtu, këtu e në vazhdim së bashku referuar si ‘**Palët**’ dhe në mënyrë individuale si ‘**Pala**’.

Palët bien dakord që të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshje të shprehura si më poshtë:

Neni 1
OBJEKTI I MARRËVESHJES

1.1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi konsiston në vendosjen e bashkëpunimit dhe angazhimit ndërmjet palëve për të ndërtuar një bashkëpunim me qëllim të dhënies së kontributit në fuqizimin dhe zhvillimin profesional të studentëve dhe të sapo diplomuarve.

1.2. Bazuar në parimin e interesit të ndërsjellë, palët duke respektuar pavarësinë e njëra tjetrës, pajtohen të promovojnë:

- i. Shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapësirave që studentët e UHZ-së (të të gjitha njësive akademike dhe të gjitha viteve dhe niveleve të studimit) të realizojnë mundësinë e punës praktike (internship) apo punës vullnetare sipas planit të paraparë nga YMCA;

1.3 Përzgjedhja e studentëve/sapo diplomuarve për programin e praktikës dhe numrit të tyre do të bëhet sipas kritereve dhe politikave të organizatës YMCA dhe në koordinim me Zyrën për Zhvillim të Karrierës të UHZ-së.

Neni 2 FUSHAT E ZBATIMIT

2.1. Bashkëpunimi ndërmjet dy Palëve do të jetë në këto fusha të zbatimit:

a) Studentët e universitetit do të marrin pjesë në trajnimet e organizur nga YMCA në kuadër të programit "Fuqizimi i të rinjëve përmes mundësive të reja" dhe pas përfundimit me sukses të trajnimit mund të ndjekin punën praktike në kuadër të këtij programi:

b) Zhvillimin e leksioneve të hapura me tematika të ndryshme nga ana e YMCA:

c) Zhvillimin e pyetësorëve, seminareve dhe konferencave të përbashkëta;

d) Bashkëpunim në realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e këshillimit të karrierës për studentët e UHZ-së si për shembull, por pa u kufizuar në:

i. Pjesëmarrjen në panairt e punës të organizuar nga Zyra për Zhvillim të Karrierës e UHZ-së për studentët dhe të sapo diplomuarit;

ii. Shkëmbimin e ndërsjellët të informacionit dhe publikimin e mundësive të punësimit të ofruara rast pas rasti për studentët nga YMCA në platformën E-karriera, rrjete sociale, web faqes së UHZ-së apo ambientet e Universitetit përmes sesioneve informuese me studentë;

e) Krijimin dhe lehtësimin e logjistikës (ambiente, teknologji, etj.) në mënyrë të ndërsjellët për organizimin e aktiviteteve sipas këtyre fushave të zbatimit si p.sh. të seminareve, trajnimeve, testeve të studentëve, kandidatë për punësim pranë YMCA-së, panairt pune etj;

ë) Bashkëpunime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha që janë objekt veprimtarie të Palëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre të ngushtë;

f) Informim reciprok mbi shkëmbimin e informacionit, i cili ka lidhje me veprimtarinë e përbashkët të këtyre dy institucioneve si dhe promovimi i dyanshëm i aktiviteteve të përbashkëta;

2.2. Gjithashtu, palët do të jenë të lira të bashkëpunojnë dhe me subjekte të tjera juridike fitimprurës ose jofitimprurës, pjesë e grupeve përkatëse.

2.3. Palët e mësipërme bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e interesit të përbashkët dhe në përputhje me parashikimet e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

3.1. Çdo aktivitet të ndërmarrë nga palët me qëllim të realizimit të kësaj marrëveshje duhet paraprakisht të merret miratimi nga zyrtarë të caktuar nga secila palë.

3.2. Palët do të nxisin njëra tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjerë dhe intensivë duke eksploruar fusha të reja bashkëpunimi dhe duke forcuar ato aktuale.

3.3. Palët do të angazhohen në mënyre të ndërsjellët për promovimin e emrit të mirë, aktivitetit, shërbimeve dhe produkteve të realizuar nga Pala tjetër sa herë që u jepet mundësia gjatë veprimtarive të tyre publike dhe private.

3.4. Secila nga Palët do të ruaje konfidencialitetin dhe sekretet tregtare dhe/ose të praktikës së aktivitetit të njëra- tjetrës, për të cilat do të marrin dijeni si rrjedhojë e bashkëpunimit të ndërsjellët.

3.5. Palët marrin përsipër që të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës burimet njerëzore dhe materiale të nevojshme për arritjen e qëllimeve që parashikon kjo marrëveshje.

3.6. Nëse e gjejnë të nevojshme, Palët nëpërmjet një aneksi dhe/ose marrëveshjeje të posaçme, do të përcaktojnë detajet e nevojshme në lidhje me fushat e veçanta të zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E VEÇANTA

4.1 Përveç sa parashikohet nga dispozitat e tjera të kësaj marrëveshje, Palët do të kenë të drejtat dhe detyrimet e veçanta të mëposhtme.

a) YMCA, në varësi të kapaciteteve dhe nevojave të saj si dhe duke aplikuar të gjitha procedurat standard të testimit të aplikueshme, do të mundësojë zhvillimin e praktikave profesionale apo punës vullnetare për studentët e Universitetit, nëpërmjet ofrimit të angazhimit të studentëve në projekte që kanë lidhje me programet e studimit që ofrohen nga UHZ, si dhe duke mbështetur implementimin në praktikë, të dijeve dhe aftësimin profesional të studentëve

b) YMCA, do të mundësojë dhënien e informacionit (jo konfidencial) për studentët dhe stafin akademik, që do të përdoret për ndërtimin e rasteve studimore, temat e diplomave, projekte të kursit, prezantime, botime dhe publikime të ndryshme, qëllime kërkimore, studimore dhe shkencore, etj.

c) UHZ mund të ftojë si lektor (të ftuar, drejtues apo ekspert të personelit të YMCA-së) në orët e leksioneve, seminareve, debateve që përfshihen në kurrikulën mësimore dhe aktivitetet me tematikë të njëjtë për të dyja palët.

d) UHZ, do të ftojë përfaqësues të YMCA-së në aktivitetet e tij publike, si konferenca, simpoziume, debate akademike dhe profesionale, të cilat janë me interes të përbashkët, ku ato mund të prezantojnë tema dhe çështje të ndryshme.

Neni 5

AFATI I MARRËVESHJES

5.1. Kjo marrëveshje lidhet për një afat kohorë të pacaktuar.

5.2. Afati i marrëveshjes fillon nga data e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e të dyja Palëve.

Neni 6

KOMUNIKIMI

6.1. Me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informacioneve të jetë i shpejtë, korrekt dhe i efektshëm për Universitetin "Haxhi Zeka" kontakti do të jetë përmes Zyrës për Zhvillim të Karrierës, sipas kontaktit ne email adresën: qzhk@unhz.eu; abedin.selimaj@unhz.eu; leonora.zefi@unhz.eu dhe numrin kontaktues: 045 712 712, dhe për organizatën YMCA do të jetë zyra në e YMCA në Pejë me personin e kontaktit: Elira Ahmetxhekaj email elira@ymca.org dhe numrin kontaktues: 049184315.

Neni 7

PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

7.1 Palët kanë të drejtë që me marrëveshje me shkrim midis tyre, të zgjidhin marrëveshjen.

7.2. Në rast të mosmarrëveshjeve në mes të palëve, palët janë të obliguara që të formojnë një komision për tejkalimin e pengesave dhe shqetësimeve të paraqitura.

7.3. Në rast se njëra nga Palët kërkon të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, ajo duhet të njoftojë me shkrim brenda 3 (tre) muajve palën tjetër në mënyrë që të mundësohet përfundimi i aktiviteteve në proces.

Neni 8

DISPOZITAT E FUNDIT

8.1 Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje identike.

8.2 Palët angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.



8.3 Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua sot, me datë **06/02/2024** dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

NË DËSHMI TË KËSAJ, i nënshkruari, i autorizuar për këtë qëllim dhe duke vepruar në përfaqësimin e palëve, vendosë nënshkrimin në këtë marrëveshje në datën e treguar më poshtë:

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të YMCA MOVEMENT

Drejtori Dorina Davies



Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të Universitetit "Haxhi Zeka"

Prof. Dr. Armand Krasniqi, Rektor



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Pr. / No. <u>796</u>		Nr. i faq/ Br. str / V. o. pg <u>5</u>	
Data / Datum / Date: <u>28.03.2024</u> Pejë / Peë			